



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksimimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datën 19.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Zëvendësimin dhe Emërimin e Anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Fushë Kosovës

- I. Z.Ardit Tërnavë, emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Fushë Kosovë nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE, duke e zëvendësuar znj. Avnore Gashi-Berisha nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me vendimin e KQZ Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024 znj. Avnore Gashi-Berisha nga subjekti politik "Lëvizja VETËVENDOSJE" është emëruar anëtare e KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 19.11.2024, ka kërkuar zëvendësimin për arsyeje të dorëheqjes nga pozita e anëtares së KKZ-së, për arsyeje personale. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 19.11.2024





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datën 19.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Dizajnit të Vulës për Fletëvotime

- I. Miratohet Dizajni i vulës për fletëvotime, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen më 09.02.2025.
- II. Dizajni si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 19.11.2024

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datën 19.11.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave për Asgjësimin e Materialit Zgjedhor

- I. Miratohen Specifikat për asgjësimin e materialit zgjedhor.
- II. Specifikat si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 19.11.2024


Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ